

Fjala e Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave Ahmetaj në Konferencën Vjetore të Bankës së Shqipërisë

I nderuar President,

I nderuar Guvernator,

E nderuar Ministre,

I dashur Erik,

Të nderuar pjesëmarrës,

Është gjithnjë kënaqësi të adresosh këtë Konferencë Vjetore të Bankës që besoj është një nga Konferencat më të rëndësishme ekonomike dhe financiare në Shqipëri.

Kjo është hera e disatë që diskutojmë së bashku në të njëjtin format dhe jo pa qëllim, e aspak rastësisht, iu ktheva një moment gjithë diskutimeve që kemi bërë vitin e kaluar.

Vitin e kaluar, diskutonim sesi Shqipëria e kishte kapërcyer rrezikun e një skenari grek për ekonominë dhe përmes një pune shumë të kujdesshme në favor të konsolidimit fiskal, që edhe Guvernatori iu referua në fjalën e tij, ishte shtruar rruga për një rritje ekonomike të qëndrueshme në nivelet 4%, të nxitur nga konsumi dhe investimet, dhe të shoqëruar me një rritje serioze të punësimit.

Atëherë diskutonim sesi ju, sektori bankar, do duhet t'i përgjigjeshit ritmit të rritjes së ekonomisë apo thirrjes së qeverisë për një angazhim akoma më të madh për rritjen e kreditimit dhe pjesëmarrjen në investime të qenësishme.

Atëherë diskutonim edhe sesi, për një ekonomi si jona por jo vetëm, edhe si e të gjithë rajonit, vija ndarëse mes suksesit dhe dështimit mbetet akoma tejet e brishtë dhe gjithnjë kërcënuese pa garancitë e vazhdimin të reformave.

Sot mund të kemi një tjetër reflektim një vit më pas, por në këndvështrimin tim sfidat janë po ato dhe sërish në këndvështrimin tim, sfidat janë akoma më afër kërcënimit.

Shqipëria ka shënuar një përshpejtim të ritmit të rritjes ekonomike në 5 vitet e fundit, ndërkohë që në gjysmën e parë të vitit 2019 (në nivelet rreth 2.3%), ajo është realisht më pak krahasuar me pritshmëritë tona dhe jo vetëm, edhe me pritshmëritë e institucioneve ndërkombëtare. Këtu do doja ta provokoja pak debatin në vijim, besoj edhe specialistët këtu do ta prekin, për të konsideruar faktorët që impaktojnë një performancë pak më të ulët të ekonomisë dhe për të na dhënë mësim, atyre prej nesh që administrojnë dhe atyre prej nesh që marrin vendime, qoftë në qeveri, qoftë në legjislativ, në mënyrë që të rritet dhe përshpejtohet axhenda e reformave.

Papunësia edhe në 2019 ka vijuar trendin zbritës duke arritur në një nivel të ulët historik prej 11.5% dhe pjesëmarrja në forcat e punës mbetet më e larta në rajon. Nga ana tjetër, sërish në funksion të debatit, do të na duhet ta vlerësojmë apo më mirë ta rivlerësojmë, nëse kemi arritur ende dot të bëjmë gjënë e duhur me zhvillimin e aftësive dhe rritjen e produktivitetit.

Këtu ka një provokim të dytë, praktikisht produktiviteti i faktorëve në Shqipëri është akoma më i ulëti në rajon. A është kjo arsyeja pse eksporti është ngadalësuar këtë vit, krahasuar me vitin e kaluar apo edhe vitet e fundit, ku po t'i referohemi që nga 2014 praktikisht eksporti kërceu edhe me dy shifra? Këto janë pyetje që ky auditor dhe kjo audiencë ka mundësi që t'i asimilojë dhe të nxjerrë mbrapsht mësim për të gjithë ne që marrim vendime, apo hartojmë politika.

Më vjen mirë që në aspektin financiar, një sërë masash të ndërmarra në vitet e fundit kanë prodhuar rezultate të prekshme në ekonomi si ulja e nivelit të kredive të këqija, dhe ajo që pashë Guvernator, në atë analizë që po i bëja arsyeve të rënies, është ripagesa. Ripagesa ka brenda edhe ekzekutimin e kolateraleve. Dikur, kur ne nisëm reformën në sistemin financiar, iu referuam drejtpërsëdrejti edhe problematikës pse ndodhin gjithë këto fenomene, përfshirë rritjen e kredive të këqija, dhe një nga bankierët e vjetër të huaj në vendin tonë, gjithmonë përmendte reformën në drejtësi. Besoj që është një debat që do duhet ta diskutojmë gjatë ditës, por edhe në vazhdim, sesi ka funksionuar reforma në sistemin financiar që e bëmë së bashku me FMN, me Bankën Botërore dhe me Bankën e Shqipërisë dhe të nxjerrim konkluzione. Arsyeja pse duhet të nxjerrim konkluzione dhe duhet besoj ta kthejmë në traditë Guvernator, të paktën në aspektin ekonomik se në aspektin politik unë nuk jam aq “*senior*” sa përfaqësues të tjerë këtu në sallë, si Presidenti i Republikës. Por do duhet të kthehemi dhe të kuptojmë ku kemi bërë gabimet dhe nuk e kemi bërë traditë. Ndërtimi i traditës do duhet të na detyrojë t'i kthehemi historisë, pse na ndodhën kreditë e këqija, pse e humbëm konsolidimin fiskal, cfarë masash fiskale morëm për të përshpejtuar rritjen dhe a na funksionuan, në mënyrë që të mos bëjmë dy, tre apo katër herë të njëjtin gabim.

Pastaj të gjithë, pa përjashtim, mos më thoni jo, kemi nevojë të domosdoshme për të mësuar që borxhi i lartë është i keq. Borxhi i lartë, është i keq. Në diskutime tryezash përtej këtyre tryezave të ndricuara në aspektin financiar dhe ekonomik, vazhdon akoma fatkeqësisht diskutimi “të rrisim pak borxhin”.

Kryeministri ka pasur dhe ka presion, unë kam pasur presion, ministrja sot besoj sërish ka presion për të rritur borxhin, por ulja e borxhit do duhet të rikthehet domosdoshmëri dhe e kam thënë edhe më herët në aktivitete publike, jo vetëm domosdoshmëri, por edhe objektiv patriotik. Dhe që ta besojmë, do të duhet të edukohemi dhe mirë-edukohemi akoma më tepër për cfarë dëmi i bën borxhi ekonomisë, financave publike dhe mbi të gjitha, qytetarit.

Sigurisht që ky nuk është një debat vetëm shqiptar. Sot qeveritë, bankat qendrore dhe aktorët e tjerë në çdo ekonomi, janë “duke bërë sërish llogaritë e tyre”.

Në një vlerësim të fundit, FMN parashikon që në vitin 2019 rreth 90% e ekonomive në botë do të shënojnë ritme më të ulëta të rritjes ekonomike, pranë nivelit më të ulët të kësaj dekade.

Në ekonominë e zhvilluara, SHBA, Japoni, dhe kryesisht Eurozonë, ka një zbutje të dinamizmit të aktivitetit ekonomik. Në Kinë, rritja po fillon të ulet gradualisht nga ritmi i shpejtë që shënoi për shumë e shumë vite, gati tre dekada.

Nga ana tjetër, lufta tregtare mes ekonomive të mëdha, ku politikanët në të gjithë botën i japin të drejtë vetes, ka ngritur pikëpyetje serioze që po dominojnë tashmë qasjet dhe politikat tregtare të vendeve, por edhe besimin dhe reagimin e tregjeve e aktorëve.

Përfundimi është i qartë. Të gjithë dalin të humbur nga një luftë tregtare. FMN përlllogarit se për ekonominë globale, efekti kumulativ i konflikteve tregtare mund të sjellë një humbje prej gati 700 miliardë dollarësh deri në 2020, ose rreth 0.8% e GDP globale.

E njëjta pamje duket se po vizatohet edhe në rajonin tonë, sipas Bankës Botërore që së fundmi i ka rivlerësuar parashikimet e saj të fillim-vitit për shkak të pasigurive të shtuara. Vitin e kaluar kemi folur për mitigimin e të gjithë risqeve.

Atëherë si do të rikonceptohej axhenda e reformave, si riformulohen prioritetet, si ridizenjohen politikat dhe koordinohen veprimet mes të gjithë aktorëve ekonomikë, financiarë dhe politikë, për t'iu përgjigjur sfidave të kësaj dekade për Shqipërinë e pastaj për vendet e rajonit? Mos harroni që ka një kërcënim për ne dhe vendet e rajonit, por unë po fokusohem tek Shqipëria, është ulja e ritmit të rritjes së popullsisë, që do të duhet të gjithë politikëbërësit dhe shkencëtarët apo ekspertët e fushës, ta faktorizojnë në të gjithë faktorët e rritjes, nëse e përshpejtojnë, e ngadalësojnë apo edhe e shkatërrojnë nëse doni.

Ndërkohë, po ndalem tek debati i rritjes ekonomike; Flitet shpesh për sektorin e energjisë dhe impaktin që ai ka në ekonominë e vendit. Është e vërtetë, patjetër. Ne në sektorin energjetik dhe për një porcion jo të vogël të rritjes ekonomike, ne i dedikohemi energjisë, motit, Zotit. Megjthatë, për ta provokuar auditorin, do t'ju sillja tre shifra. Në vitin 2011, goditja negative nga energjia ka qenë -1%. Në vitin 2017, goditja nga energjia ka qenë -1.3% Cfarë do të thotë kjo? Pse në vitin 2011, rritja reale megjithë goditjen energjetike ishte 2.55% dhe në vitin 2017, megjithë goditjen më të madhe të 10 viteve të fundit nga sektori energjetik, rritja shkoi 3.82%? Kjo ka nevojë për analizë. Unë nuk do të pranoja të nxirrja konkluzion, por për të njëjtën goditje, rritja ekonomike ndryshon. Ka një faktor të panegociueshëm, reforma. Në 2017, e gjitha axhenda e reformave në "full speed" provokoi pozitivisht të gjithë fundamentet ekonomike, që ne i kemi diskutuar në vazhdimësi.

Këtu dua të nënvizoj që sektori energjetik ka nevojë të domosdoshme për vazhdimin e reformës në mënyrë që të konsolidojë të gjithë ato arritje të viteve të fundit.

Ky vend, kjo ekonomi, këto institucione, kjo shoqëri, nuk e ka luksin në asnjë sekondë të ndalojë reformat. Nuk e ka. Përtej çfarë diskutohet në podiumet politike për reforma të vazhduara apo të pavazhduara, ditën që reformat në terrenin ekonomik (pastaj patjetër në gjithë terrenet e tjera) ndalojnë, aty premisat, jo thjesht për ngadalësim por për gropë ekonomike janë shumë herë më të mëdha.

Dua të citoj ish-Kryeministrin grek Tsipras, në një shprehje brilante në këndvështrimin tim, përsa i përket reformave : *“Reformat për një ekonomi janë si t’i japësh biçikletës. Në momentin që ndalon së pedaluari, ti rrëzohesh”*.

Po i referohem sërish një studimi të FMN për rëndësinë e reformave. Implementimi i reformave strukturore në financat publike, external finances, tregti, tregun e punës dhe qeverisje, mund të rrisë prodhimin kombëtar me rreth 7% në një periudhë 6-vjecare dhe me 1 pikë përqindje normën vjetore të GDP/frymë. Sfidat që cilat janë në tryezë për ne, për të gjithë ata që administrojnë, për të gjithë ata që bëjnë politika, për të gjithë ata që janë në legjislativ.

Reformat e duhura, në kohën e duhur mund ta dyfishojnë shpejtësinë me të cilën ekonomitë në zhvillim, mund të arrijnë konvergjencën me ekonomitë e zhvilluara. Pakenaqësia e qytetarëve është mungesa e konvergjencës, pakenaqësitë e qytetarëve në të gjithë rajonin dhe botë kanë të bëjnë me atë që ti e sheh, nuk e ke, do ta arrish dhe gjen instrumenta të tjerë për ta arritur ndërkohë që arritja është nëpërmjet konvergjencës ekonomike, pra zvogëlimit të hendekut, e cila bëhet vetëm me reformat e duhura dhe të sinkronizuara.

Unë mendoj që konsolidimi fiskal është shumë i rëndësishëm. Nuk mund të relaksohemi. Pa arritur nivele të përballueshme të borxhit, nuk po i referohem asaj që ne e morëm 74% e po e cojmë 65%, nuk po i referohem kësaj, edhe 65% është akoma shumë për ekonominë tonë.

Reforma në drejtësi, e patjetërsueshme. Nuk kam nevojë fare ta debatoj, do t’i ndërrojë faqen drejtësisë, por do ta ndihmojë shumë zhvillimin ekonomik, zhvillimin shoqëror patjetër, institucional patjetër, por mbi të gjitha atë ekonomik.

Formalizimi i ekonomisë, ndoshta tingëllon i dhimbshëm, është i domosdoshëm. Nuk ka rishpërndarje nëse nuk ka formalizim, e diskutojmë si të doni. Pa formalizim, nuk ka rishpërndarje të shëndetshme, sepse ndodh një shpërndarje e madhe në “hapësirë gri”, ku deformohen politikat fiskale, politikat financiare, politikat monetare. Nuk kanë impakt nëse informaliteti është në nivele të tilla që të bllokojë efikasitetin e politikave.

Investimet për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në linjë me zhvillimet ekonomiko/teknologjike botërore, më vjen mirë që Banka Botërore e ka ritheksuar edhe në raportin e fundit, Eriku këtu iu referua si sfidë, pa të cilat nuk do të mund të rrisim produktivitetin, pa të cilin nuk jemi konkurrues, pa të cilën nuk ia dalim dot të mbajmë ritmet e qëndrueshme të rritjes, atë që e quajmë *sustainable growth*. Pa rritje të qëndrueshme do të shihnim atë që shohim shpesh, fluktuacionet në konsum.

Disa elementë përpara se ta mbyll, sa i përket sistemit bankar. Kam vënë re kudo ku kam qenë këtu apo në botë, që në përgjithësi janë paksa vetëvlerësues komunitetet financiare bankare për veten e tyre (po i referohem nivelit të dytë, jo autoritetit qendror) madje përtej tryezave mendojnë që pa ata nuk ka zhvillim. E vërtetë është. Pa ju nuk ka zhvillim. Por dy sfida të vogla do t’jua bëj në vijim.

Në Gusht 2012 kredia për ekonominë ishte 552 miliardë lekë; rritja ekonomike ishte dicka mbi 1%. Në gusht 2019, kredia është 561 miliardë lekë, pra në 7 vite, vetëm rritje 8.7 miliardë lekë (apo 1.6%). Përtej mureve, i gjithë sistemi bankar nuk duhet të jetë shumë krenar për këtë shifër. Ndërkohë që ritmet e rritjes ekonomike shkuan në 4.06%.

Në raport, me vendet e rajonit, kreditimi është i sheshtë. Kreditimi për korporatat jo-financiare në vitin 2004, 61%. Në vitin 2012, 15.5%. Po pse në vitin 2018 është vetëm 3%? Cfarë ka ndodhur? Ka pasur mungesë reformash? Jo, përkundrazi, BERZH (Erik ka qenë vetë Chief Economist), Banka Botërore, FMN, e ka cilësuar kohën më të mirë të reformave periudhën 2013-2018. Cila është arsyeja? Provokim për ju.

Pjesa tjetër është shumë interesante. Po shikoja shifrat e rritjes së kredisë, nuk po i referohem aseteve, të bankave me kapital shqiptar. Njëra prej tyre, dhe janë të dhëna publike, nuk po zbuloj asnjë sekret, është interesante të shohësh që bankat me kapital shqiptar e kanë rritur kreditimin në masë të konsiderueshme. Bankat me kapital të huaj, (po i referohem, meqënëse pronësia është dhe një nga elementët e temës dhe titullit të konferencës së sotme), e kanë marrë “me nge”. Pyetje e kam, mos u përgjigjini sot se nuk besoj është ky auditori, por bankat me kapital shqiptar janë më pak të ndërgjegjshme për riskun? Bankat me kapital të huaj, janë më të sofistikuara në përlllogaritjen e riskut në Shqipëri? Pyete e kam, nuk e di, thjesht po ju them shifra.

Rritja e kreditimit 2015-2019, BKT -16%. Credins, +19,5%. Raiffeisen Bank -28.9%. Intesa San Paolo, +1%.

Po ju sjell nëse doni edhe kreditimin nga 2010-2019: BKT, e ka ritmin e kreditimit 78.7%. Credins, 195,5%. Raiffeisen -7.4% dhe Intesa San Paolo -9%.

Po si është e mundur, çfarë ka ndodhur, tani që ulen kreditë e këqija, tani që bëhen reforma, nuk ka kreditim?! Bankat me kapital shqiptar japin, bankat me kapital të huaj janë pak më të sofistikuara tek risku. Besoj që shumica juaj që jeni bankierë, do të na mësoni.

Së fundmi Guvernator, gjithashtu një provokim sa i përket *crypto currencies*, ka ardhur besoj momenti që autoriteti rregullator, por edhe ligjbërësit të mendojnë seriozisht sepse *crypto currencies* sa mund të jenë një bekim, mund të kthehen edhe në një mallkim, sidomos për ekonomi dhe sisteme si tonat. Besoj që duhet futur në axhendën e diskutimit mes jush, qeverisë dhe ligjvënësit.

Faleminderit për ftesën, ju uroj punime të mbara!